



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
K U V E N D I**

PROJEKTLIGJ

NR. 9741, datë 21/05/2007

PËR

ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 37

Njohja e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të huaj

1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njehsohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e certifikatave, gradave ose titujve të huaj.
2. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të diplomave ose certifikatave, të lëshuara nga Institucione të huaja të Arsimit të Lartë është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila e kryen këtë proces nëpërmjet njësisë përgjegjëse të njohjes së diplomave, që funksionon edhe si Qendra Kombëtare e Njohjes së Diplomave dhe e Informimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës kanë të drejtë të autorizojë Institucionet e Arsimit të Lartë për kryerjen e këtij procesi për rastet e njehsimit të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin. Këto raste përcaktohen me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
3. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë i gradave ose titujve shkencorë, të lëshuar nga Institucione të huaja të Arsimit të Lartë është Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë.
4. Procedurat dhe kriteret për njohjen e diplomave, certifikatave, gradave e titujve të lëshuar nga Institucione të huaja të Arsimit të Lartë përcaktohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.

Neni 38

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. Nëpërmjet ekuivalentimit, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në Institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
2. Ekuivalentimi bëhet nga Institucioni i Arsimit të Lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm.
3. Procedurat dhe kërkesat për ekuivalentim përcaktohen në statutet e Institucioneve të Arsimit të Lartë, në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.